



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.537/3 prot.

Tiranë, më 27. 07. 2023

V E N D I M

Nr. 146, datë 27. 07. 2023

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 67, datë 27.04.2023, të paraqitur nga A. B. kundër Departamentit të Administratës Publike¹ dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve², në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes shëndetësore”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

A. B. në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka parashtruar ndër të tjera se: “Në bazë të shpalljes publike nga DAP, i pozicionit 4408, Zv. Drejtor i Përgjithshëm i Mbështetjes së Programeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, kam aplikuar për këtë pozicion direkt në portalin e DAP, ku nga verifikimi paraprak nga DAP nuk jam kualifikuar për mungesë dokumentacioni dhe konkretisht: “Nuk kam ngarkuar të plotë vlerësimin e fundit të punës (periudha Janar-Qershor 2022). Mungon vlerësimi i punës për periudhën 01.01.2022-31.03.2022 dhe mu la afat 5 ditore që të ngarkoja në sistem mangësitë në vlerësimin e fundit. Veprim të cilin e realizova brenda këtij afati 5 ditore.

Në përfundim të verifikimit, DAP më ka kualifikuar në pozicionit 4408, Zv. Drejtor i Përgjithshëm i Mbështetjes së Programeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe ka vendosur që testimi me shkrim do të zhvillohej në datën 07.02.2023, ora 13.30 në ambientet e DAP dhe po atë ditë në orën 14.00 intervista e strukturuar me gojë.

Njoftimi i DAP në portal më është bërë më datë 03.02.2023, ora 14.00, ditë e premte. Më datë 15.01.2023 më ndodhi një aksident ku pësova frakturë (thyerje) në duar dhe si rezultat Komisioni Mjeko Ligjor më trajtoi me raport për paaftësi të përkohshme në punë që paguhen nga Sigurimet

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin DAP.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin DPT.

³ Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD.

Shoqërore për periudhën 15.01.2023 deri 14.02.2023, raport i cili u përsërit edhe për 30 ditë të tjera se fraktura ishte e rëndë.

Nisur nga sa parashtrova më sipër duke qenë se kualifikimin për të marrë pjesë në procedurën 4408 Zv. Drejtor i Përgjithshëm i Mbështetjes së Programeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në portal DAP e kishte hedhur në orën 14.00 të datës 03.02.2023, ditë e premte, duke qenë se dita e shtunë dhe e diel për administratën është pushim, ia kam dërguar DAP më datë 06.02.2023, ditën e hënë, ora 10.00 kërkesën për shtyrjen e procedurës në një datë tjetër, për pamundësi shëndetësore dhe fizike (Kam qenë në kushte krevati me pamundësi lëvizje rreth dy muaj) që unë të marr pjesë në procedurë duke i bashkangjitur dhe raportin mjekësor nga KLM.

Kërkesa me raportin mjekësor, DAP i kanë shkuar po atë ditë në datë 06.02.2023, në ora 15.00...

Me shkresë të DAP nr. 641/1 prot., datë 21.02.2023 “Mbi kërkesën në lidhje me procedurën e shpalljes 4408”, më është kthyer përgjigje se DAP nuk e njeh Raportin për paaftësi të përkohshme në punë të lëshuar nga KML dhe se procedurën nuk e shtyn në një datë tjetër.

Përgjigja më është kthyer mbas dy javësh pas kërkesës time për shtyrje, kur në fakt ishte vendosur fituesja e kësaj procedure pa respektuar fare kërkesat e ligjit “Kodi i Procedurave Administrative”.

Veprimet e mësipërme janë bërë me qëllim nga DAP dhe DPT për të favorizuar kordinatoren (Këshilltaren, pozicion politik) e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve për ta emëruar Zv. Drejtor të Përgjithshëm i Mbështetjes së Programeve, veprim të cilin e kanë kryer duke e emëruar në këtë pozicion si nëpunëse civile të pozicionit të mesëm Drejtues pa respektuar kërkesat e ligjit “Për nëpunësin civil”, duke më diskriminuar mua me një karrierë 30 vjeçare në Administratën Publike si nëpunës civil i nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues.”

Në përfundim, ankuesi kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit nga ana e Departamentit të Administratës Publike dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për shkak të gjendjes shëndetësore.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar⁴, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

⁴ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

Neni 3, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përbashkëtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 537/1 prot., datë 15.05.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, neni 32, pika 2, ka kërkuar nga ana e Departamentit të Administratës Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, që të jepen parashtrime lidhur me të gjitha pretendimet e ngritura, nga subjekti ankues, si dhe ka kërkuar informacion dhe dokumentacionin si më poshtë:
 - Infomacion mbi pretendimet e ngritura nga ana e A. B.
 - Informacion dhe kopje të korrespondencës së mbajtur me subjektin ankues.
 - Informacion lidhur me arsyet përse nuk është aprovuar kërkesa e subjektit ankues për të shtyrë konkurimin për një datë tjetër.
 - A ka patur raste të ngjashme me ankuesin ku konkurimi për një pozicion pune është shtyrë për shkak të gjendjes shëndetësore të aplikantëve? Nëse, po të vihet në dispozicion informacioni i kërkuar.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Departamenti i Administratës Publike, me shkresën⁵ Nr. 2675/1 prot., datë 05.06.2023, informoi Komisionerin ndër të tjera se: “Bazuar në nenin 26, të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe në Vendimin Nr. 242, datë

⁵ Protokolluar pranë Komisionerit me shkresën Nr. 537/2 prot., datë 07.06.2023

18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar, procedura e konkurrimit për ngritjen në detyrë zhvillohet në dy faza, përkatësisht në fazën e verifikimit paraprak ku verifikohet nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkurrimit dhe në fazën e vlerësimit të kandidatëve. Faza e verifikimit paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse DAP, për institucionet e administratës shtetërore, ndërsa vlerësimi i kandidatëve bëhet nga Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyrë.

Në fazën e verifikimit paraprak për procedurën e ngritjes në detyrë, kodi i shpalljes 4408, për pozicionin: Zëvendës drejtor i Përgjithshëm i Mbështetjes së Programeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve - kategoria: II-b, njësia përgjegjëse DAP, ka skualifikuar A. B. nga procedura e konkurrimit, pasi nuk kishte ngarkuar të plotë formularin e vlerësimit të punës.

Brenda afateve procedurale, A. B. ka paraqitur ankesë dhe ka plotësuar dokumentacionin e aplikimit për këtë procedurë konkurrimi, duke u kualifikuar nga njësia përgjegjëse për fazën vijuese të konkurrimit atë të vlerësimit të kandidatit (testimi me shkrim/intervista me gojë/vlerësimi i jetëshkrimit). Për kualifikimin në fazën vijuese të konkurrimit kandidati është njoftuar në përfundim të afateve të shqyrtimit të ankesave, konkretisht më datë 03.02.2023.

Sipas shpalljes me kod 4408, testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë për procedurën e ngritjes në detyrë, për pozicionin: Zëvendës drejtor i Përgjithshëm i Mbështetjes së Programeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve - kategoria: II-b, është caktuar të zhvillohet në ambientet e DAP më datë 07.02.2023, ora 13:30 (testimi) dhe ora 14.00 (intervista) <https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/3930/4/13>.

Më datë 06.02.2023, pra vetëm një ditë përpara zhvillimit të konkurrimit, A. B. ka paraqitur kërkesë, protokolluar me tonën Nr. 2675 prot., datë 06.02.2023, me të cilën ka kërkuar shtytjen e datës së zhvillimit të procedurës së konkurrimit, për shkak të raportit mjekësor, bashkëlidhur kërkesës, me të cilin i interesuari është trajtuar me raport mjekësor për paaftësi në punë.

Lidhur me raportin mjekësor që ka paraqitur A. B., përkatësisht të datës 17.01.2023, DAP ka konstatuar se shkak i pamundësisë së pjesëmarrjes së kandidatit në procedurën e ngritjes në detyrë ka ndodhur të paktën më datë 17.01.2023, ndërkohë që testimi me shkrim dhe intervista me gojë janë caktuar që më datë 23.01.2023, në përfundim të fazës së verifikimit paraprak, DAP ka konstatuar se periudha kohore midis shkakut të pamundësisë së pjesëmarrjes në testimin me shkrim dhe intervistën me gojë ka qenë të paktën 20 ditë, afat i mjaftueshëm ky që të informohej njësia përgjegjëse për shkakun e pamundësisë. Për më tepër, A. B. është telefonuar nga njësia përgjegjëse dhe është njoftuar se mund t’i ofrohet asistencë teknike për plotësimin e fletës me barkode në testimin me shkrim, por ka refuzuar. Asistencë teknike ofrohet nga njësia përgjegjëse DAP në të gjitha rastet kur kandidati është në pamundësi për të plotësuar tezën me shkrim, kryesisht në rastet kur kandidatët kanë paaftësi të kategorive të ndryshme në shikim, kanë statusin e invalidit paraplegjik, apo paaftësi të tjera të përkohshme, etj.

Lidhur me rastet e ngjashme ku konkurrimi është shtyrë me kërkesë të subjektit ankues, ju informojmë se bazuar në nenin 20, të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, procedurat për plotësimin e vendeve vakante të shpallura nga njësia përgjegjëse DAP, janë kombëtare. Kjo nënkupton, përveç të tjerave, se procedura është unike dhe e papërsëritshme, pra zhvillohet një herë të vetme, në vendin, datën dhe orën e caktuar ashtu si shpallen në faqen

zyrtare web të DAP. Në të njëjtën mënyrë zhvillohen një herë të vetme në datën, vendin dhe orën e caktuar provimet/konkurset p.sh. për të fituar licencën për profesionin e rregulluar të mësuesit të organizuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore, apo licencën e Avokatit, të organizuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, etj.

Raste përjashtimore, ku ka rezultuar se është shtyrë data dhe ora e zhvillimit të një procedure konkurrimi me kërkesë të justifikuar me dokumentacionin përkatës të kandidatit ankues, janë ato kur janë plotësuar kushtet si më poshtë:

- i. Në procedurën e konkurrimit është kualifikuar një kandidat i vetëm;
- ii. Njësia përgjegjëse është njoftuar për arsyen e ligjshme të pamundësisë së pjesëmarrjes në procedurë nga kandidati i vetëm në kohë të mjaftueshme për të kryer veprimet administrative të nevojshme, sipas afateve të përcaktuara në Vendimin Nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar dhe në Vendimin Nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar;
- iii. Anëtarët e Komisionit të ngritur sipas afateve të legjislacionit të shërbimit civil kanë vlerësuar se për arsye të ligjshme të provuara nga kandidati, testimi me shkrim apo intervista me gojë mund të zhvillohet në një datë të mëvonshme. Në vlerësimin e shtyrjes së datës së zhvillimit të testimit me shkrim/intervistës me gojë, Komisioni mban në konsideratë nevojat e institucionit për plotësimin e vendit vakant, referuar afateve ligjore për rishpalljen e vendit vakant nga njësia përgjegjëse kur ai nuk plotësohet nëpërmjet procedurës së konkurrimit.

Ju informojmë se një rritje e numrit të rasteve kur me kërkesë të justifikuar (raport mjekesor) të ankuesit është shtyrë data e zhvillimit të procedurës së konkurrimit, është konstatuar nga njësia përgjegjëse DAP gjatë periudhës së pandemisë Covid-19...”.

Në përgjigje të informacionit të kërkuar nga Komisioneri, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk vuri në dispozicion të çështjes asnjë parashtrim me shkrim.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikojnë se: “‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e

subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësoje me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”*.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ndryshuar, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij”*.

Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 12/1/b, ku përcaktohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ... b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve;”*, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, bazuar në gjendjen shëndetësore, që i bëhet një punëmarrësi në gëzimin e të drejtës për punësim.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, rezulton se:

Në muajin dhjetor 2022, ankuesi është vënë në dijeni të shpalljes publike nga DAP, të pozicionit me kod 4408, Zv. Drejtor i Përgjithshëm i Mbështetjes së Programeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. I interesuar për vend pune, ankuesi ka paraqitur aplikimin e tij për këtë pozicion në portalin e DAP, brenda datës 20.01.2023, të përcaktuar në shpalljen e pozicionit të sipërcituar për aplikimin dhe dorëzimin e dokumentave online për procedurën e ngritjes në detyrë.

Neni 26, i Ligjit Nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, *“Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese”*, parashikon se: “

1. Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët ose të mesme drejtuese bëhet, së pari, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe, në rast të mosplotësimit të vendit të lirë, me procedurën e ngritjes në detyrë.

2. Këto procedura organizohen nga njësi përgjegjëse, për një ose disa pozicione të lira të ngjashme, bazuar në parimin e përmendur në nenin 20 të këtij ligji.

3. Mund të aplikojnë për procedurat, sipas pikës 1 të këtij neni:

a) nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për vendin/vendet e lira nëpërmjet lëvizjes paralele; b) nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse, të punësuar në të njëjtin apo në një

institucion tjetër të shërbimit civil, nëse plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për vendin/vendet e lira, nëpërmjet ngritjes në detyrë.

4. Përrjashtimisht, Këshilli i Ministrave, për institucionet e administratës shtetërore dhe organi kompetent për institucionet e pavarura mund të vendosë që procedura e plotësimit të vendeve të lira për kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese të jetë e hapur edhe për kandidatët të tjerë që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin/vendet e lira. Në çdo rast plotësimi i vendeve të lira në këtë kategori nuk mund të kalojë 20 për qind të numrit total të vendeve në çdo vit kalendarik.

5. Konkurrimi zhvillohet në dy faza:

a) verifikimi paraprak, nëse kandidatët plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për vendin/vendet e lira;

b) vlerësimi i kandidatëve.

6. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi i kandidatëve bëhet nga komiteti i pranimit, që ngrihet nga njësia përgjegjëse.

7. Në përfundim të vlerësimit, komiteti mund të vendosë:

a) përzgjedhjen e kandidatit që është renditur i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 për qind të pikëve; apo

b) përfundimin e procedurës pa asnjë të përzgjedhur, në rast se asnjë nga kandidatët nuk ka marrë të paktën 70 për qind të pikëve.

8. Nëse vendi i lirë nuk plotësohet nëpërmjet procedurës së parashikuar në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, nëse është e nevojshme, mund të zbatohet procedura e transferimit të përkohshëm në interes të institucionit, sipas shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 48 të këtij ligji.

9. Këshilli i Ministrave miraton kushtet dhe procedurën e hollësishme për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese.”

Në Kreun III të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 242, datë 18.03.2015, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar, parashikon:

“...21. Konkurrimi për procedurën e ngritjes në detyrë përfshin dy faza:

a) verifikimin paraprak, nëse kandidatët plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për vendin/vendet e lira, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim;

b) vlerësimin e kandidatëve.

22. Njësia përgjegjëse, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimit të tyre, bën verifikimin paraprak të kandidatëve, që përmbushin kushtet dhe kërkesat e veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

... 25. Kandidatët, që nuk plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim, renditen në një listë të veçantë, në të cilën tregohen edhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kërkesave. Lista administrohet nga njësia përgjegjëse dhe nuk bëhet publike. Kandidatët që nuk janë kualifikuar njoftohen individualisht nga njësia përgjegjëse.

26. Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual, në përputhje me pikën 25 të kreut III të këtij vendimi, kandidatët që nuk janë kualifikur kanë të drejtë të paraqesin ankesë me shkrim pranë njësisë përgjegjëse. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

27. Në vlerësimin e kandidatëve, përfshihen:

a) vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, përvojës e trajnimeve, të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve individuale në punë;

b) vlerësimi me shkrim;

c) intervista e strukturuar me gojë.

... 35. Kandidati, pavarësisht nga e drejta për t'u ankuar në gjykatën administrative, ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim edhe në KPND për rezultatin e pikëve, brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual për rezultatin e vlerësimit. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

36. Njësia përgjegjëse, brenda 3 (tri) ditëve kalendarike, pas përfundimit të procedurave të ankimit, shpall fituesin dhe bën aktin e emërimit të kandidatit.

....

38. Njësia përgjegjëse pas marrjes së mendimit zyrtar nga kandidati/kandidatët fitues, shpall fituesin/fituesit dhe bën aktin e emërimit të kandidatit/kandidatëve...”.

Sa më lart, për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, procedura e konkurrimit për ngritjen në detyrë zhvillohet në dy faza, përkatësisht në fazën e verifikimit paraprak, ku verifikohet nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkurrimit dhe në fazën e vlerësimit të kandidatëve. Faza e verifikimit paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse DAP, për institucionet e administratës shtetërore, ndërsa vlerësimi i kandidatëve bëhet nga Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyrë.

Në fazën e verifikimit paraprak për procedurën e ngritjes në detyrë, për pozicionin për të cilin ka aplikuar ankuesi: Zëvendës drejtor i Përgjithshëm i Mbështetjes së Programeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, njësia përgjegjëse DAP, e ka njoftuar ankuesin përmes së llogarisë së tij në faqen web të Departamentit të Administratës Publike, se e ka skualifikuar atë nga procedura e konkurrimit, pasi nuk kishte dorëzuar formularin e vlerësimit të punës për periudhën Janar-Qershor 2022. Mbështetur në pikën 25 dhe 26 të Kreut III, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 242, datë 18.03.2015, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, të ndryshuar, ankuesit i është lënë afat që brenda 5 ditëve të plotësojë dokumentacionin e plotë për procedurën e ngritjes në detyrë.

Brenda afateve procedurale, pra brenda datës 24.01.2023, ku kandidatët do të njoftoheshin për të vazhduar për fazën e dytë të konkurrimit, ankuesi ka paraqitur ankesë dhe ka plotësuar dokumentacionin e aplikimit për këtë procedurë konkurrimi, duke u kualifikuar nga njësia përgjegjëse për fazën vijuese të konkurrimit atë të vlerësimit të kandidatit (testimi me shkrim/intervista me gojë/vlerësimi i jetëshkrimit). Për këtë ankuesi është njoftuar sërish në llogarinë e tij, duke u bërë me dije se është kualifikuar për fazën tjetër të procedurës së ngritjes në detyrë.

Sipas informacionit të administruar, për kualifikimin në fazën vijuese të konkurrimit ankuesi është njoftuar në përfundim të afateve të shqyrtimit të ankesave (plotësimi të dokumentacionit të munguar), konkretisht më datë 03.02.2023.

Referuar shpalljes me kod 4408⁶, 2 (dy) kandidatët e kualifikuar, ankuesi dhe shtetasja D. Ç, janë njoftuar se testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë për procedurën e ngritjes në detyrë, për pozicionin: Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Mbështetjes së Programeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, është caktuar të zhvillohet në ambientet e DAP më datë 07.02.2023, ora 13:30 (testimi) dhe ora 14.00 (intervista).

Mbështetur në dokumentacionin e administruar dhe informacionin e dhënë, ankuesi më datë 15.01.2023, ka pësuar një aksident, në të cilin ka dëmtuar (thyer) një prej duarve, si rezultat është trajtuar me Raport për Paaftësi të Përkohshme në Punë Nr. rregj. 68, datë 17.01.2023, për një periudhë 30 ditore si fillim e më pas ka marrë edhe 30 ditë të tjera.

Pasi ankuesi është vënë në dijeni të njoftimit publik ditën e premte, datë 03.02.2023, të bërë nga DAP për zhvillimin e testimit me shkrim dhe intervistës me gojë për procedurën e ngritjes në detyrë, i është drejtuar në rrugë zyrtare këtij të fundit, duke dërguar me anë të postës kërkesën për shtyrjen e testimit për shkak të gjendjes shëndetësore në të cilën ndodhej. Nga informacioni i administruar, kërkesa e tij është administruar nga DAP ditën e hënë, datë 06.02.2023. Pra 1 ditë përpara datës së caktuar për zhvillimin e testimit.

Nga përmbajtja e dokumentacionit mjekoligjor dhe informacioni i dhënë nga ankuesi, konstatohet se ai ka qenë në pamundësi shëndetësore për të marrë pjesë në testimin me shkrim dhe intervistën me gojë të paktën që prej datës 15.01.2023. Ndërkohë që data për realizimin e testimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë për procedurën e ngritjes në detyrë, referuar *“Njoftimit mbi rezultatet e verifikimit paraprak për ngritje në detyrë në kategorinë e mesme dhe e ulët drejtuese”*, të bërë publik në faqen zyrtare web të Departamentit të Administratës Publike, është përcaktuar që në fazën e verifikimit paraprak më datë 24.01.2023, kur ankuesi është vënë në dijeni për skualifikimin e tij si rezultat i mungesës së formularit të vlerësimit të punës për periudhën Janar-Qershor 2022. Në njoftimin⁷ e publikuar, pasi bëhet publik emri i kandidatit të kualifikuar për fazën tjetër të konkurimit, citohet se: *“A. Testimi me shkrim do të zhvillohet në datën 7.2.2023., ora 13:30, në ambientet e Departamentit të Administratës Publike, Bulevardi "Zogu I", Tiranë.*

B. Intervista e strukturuar me gojë do të zhvillohet më datë 7.2.2023, ora 14:00, në ambientet e Departamentit të Administratës Publike, Bulevardi "Zogu I", Tiranë”. Referuar këtij njoftimi dhe përmbajtjes së dokumentacionit mjekoligjor, ankuesi ka marrë dijeni lidhur me datën e zhvillimit të testimit me shkrim dhe intervistës me gojë, gjatë kohës që është trajtuar me Raport për Paaftësi të Përkohshme në Punë.

Në përfundim përsa më lart, Komisioneri gjykon se ankuesi ka patur të gjithë kohën e mjaftueshme për të njoftuar strukturat përgjegjëse të DAP, lidhur me gjendjen shëndetësore të tij dhe pamundësinë për të marrë pjesë në procedurat e konkurimit për pozicionin: Zëvendësdrejtor i

⁶ <https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/3930/4/13>

⁷ <https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/3930/4/12>

Përgjithshëm i Mbështetjes së Programeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Refruar informacionit të analizuar, ankuesi ka patur mundësinë të njoftonte DAP-in të paktën në momentin e njoftimit publik të bërë nga Departamenti, ku njoftohej se ankuesi është skualifikuar gjatë verifikimit paraprak të dokumentacionit, më datë 24.01.2023.

Megjithatë, sipas informacionit të parashtruar nga DAP⁸, pavarësisht faktit që ankuesi nuk ka patur mundësi të marrë pjesë në testimin me shkrim apo intervistën me gojë, ai është telefonuar nga njësia përgjegjëse dhe është njoftuar se mund t'i ofrohet asistencë teknike për plotësimin e fletës me barkode në testimin me shkrim, por ka refuzuar. Sipas DAP, asistencë teknike ofrohet nga njësia përgjegjëse DAP në të gjitha rastet kur kandidati është në pamundësi për të plotësuar tezën me shkrim, kryesisht në rastet kur kandidatët kanë paaftësi të kategorive të ndryshme në shikim, kanë statusin e invalidit paraplegjik, apo paaftësi të tjera të përkohshme, etj.

Lidhur me këtë pretendim, Komisioneri i përcolli ankuesit shkresën e sipërcituar me e-mail-in datë 26.06.2023, për të parashtruar pretendimet e tij, por nga ana e këtij të fundit nuk u paraqit asnjë argument për të hedhur poshtë pretendimin e DAP-it sa i përket faktit nëse i është ofruar ose jo asistencë teknike për plotësimin e fletës me barkode në testimin me shkrim.

Sakaq, nga informacioni i dhënë nga ana e DAP, rezulton se gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, ka patur raste si në atë të subjektit ankues, që është shtyrë data e zhvillimit të procedurave të konkurimit për shkak të rritjes së numrit të kërkesave të justifikuara (me raport mjekësor).

Gjithashtu, raste përjashtimore të tjera, sipas DAP, ka patur kur ka rezultuar se është shtyrë data dhe ora e zhvillimit të një procedure konkurrimi me kërkesë të justifikuar me dokumentacionin përkatës të kandidatit ankues, kur janë plotësuar kushtet si më poshtë:

- i. Në procedurën e konkurimit është kualifikuar një kandidat i vetëm;
- ii. Njësia përgjegjëse është njoftuar për arsyen e ligjshme të pamundësisë së pjesëmarrjes në procedurë nga kandidati i vetëm në kohë të mjaftueshme për të kryer veprimet administrative të nevojshme, sipas afateve të përcaktuara në Vendimin Nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, i ndryshuar dhe në Vendimin Nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”*, i ndryshuar;
- iii. Anëtarët e Komisionit të ngritur sipas afateve të legjislacionit të shërbimit civil kanë vlerësuar se për arsye të ligjshme të provuara nga kandidati, testimi me shkrim apo intervista me gojë mund të zhvillohet në një datë të mëvonshme. Në vlerësimin e shtyrjes së datës së zhvillimit të testimit me shkrim/intervistës me gojë, Komisioni mban në konsideratë nevojat e institucionit për plotësimin e vendit vakant, referuar afateve ligjore për rishpalljen e vendit vakant nga njësia përgjegjëse kur ai nuk plotësohet nëpërmjet procedurës së konkurimit.

⁸ Nr. 2675/1 prot., datë 05.06.2023, drejtuar KMD-së.

Në analizë të veprimeve të kryera nga Departamenti i Administratës Publike, rezulton se nga ana e këtij institucioni janë kryer të njëjtat veprime dhe është mbajtur i njëjti qëndrim lidhur me trajtimin kërkesave për shtyrjen e datë dhe orës së zhvillimit të një procedure konkurrimi.

Sa i përket pretendimit të ankuesit se është diskriminuar për shkak të gjendjes shëndetësore nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Komisioneri gjykon se referuar parashikimeve të legjislacionit dhe akteve nënligjore për nëpunësin civil, ky institucion nuk ka përgjegjësi apo kompetencë në zhvillimin e procedurës administrative për pozicionin me kod 4408, Zv. Drejtor i Përgjithshëm i Mbështetjes së Programeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve apo përzgjedhjen e kandidatëve fitues për këtë pozicion vakant. Në këtë kuptim, Komisioneri konstaton se pretendimi për diskriminim drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, nuk është i mbështetur në faktet dhe provat e administruara gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesë.

Në përfundim, Komisioneri gjatë analizës së informacionit dhe provave të sipërcituara, konstatoi se:

- Nga ana e DAP-it, janë ndjekur të gjithë procedurat dhe hapat, në mbështetje të akteve ligjore/nënligjore, procedurën e ngritjes në detyrë, për pozicionin: Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Mbështetjes së Programeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.
- Ankuesi nuk është vendosur në kushte të pabarabarta nga ana e DAP-it, pasi ky institucion ka mbajtur të njëjtin qëndrim lidhur me trajtimin kërkesave për shtyrjen e datë dhe orës së zhvillimit të një procedure konkurrimi.
- Ankuesi, pavarësisht se ka patur kohën e mjaftueshme për të njoftuar DAP-in për shtyrjen e procedurave të testimit me shkrim dhe intervistës me gojë, edhe pse ka patur komunikime të mëparshme me këtë institucion, e ka vënë në dijeni mbi kërkesën e tij vetëm 1 ditë përpara zhvillimit të procedurave të mëtejshme të konkurimit.
- Komisioneri gjykon se, DAP duke marrë në konsideratë nevojat e institucionit për plotësimin e vendit vakant dhe kohën e pamjaftueshme për të njoftuar kandidatin tjetër për shtyrjen e datës dhe orës së zhvillimit të testimit, në respektim të legjislacionit dhe akteve nënligjore për nëpunësin civil ka vijuar më tej procedurat e konkurimit për pozicionin vakant: Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Mbështetjes së Programeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si nga ligjet në fuqi”*.

Në nenin 12/1/b) të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në*

nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve”.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7/1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri vlerëson se Departamenti i Administratës Publike, nuk ka ndërmarrë veprime që e kanë ekspozuar subjektin ankues ndaj një trajtimi të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje të paligjshme nga ana e Departamentit të Administratës Publike, për shkakun e pretenduar nga ankuesi dhe për rrjedhojë nuk provohet se Departamenti i Administratës Publike ka shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 1, 3/1, 5/1, neni 7/1, neni 12/1/b, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të A. B., për shkak të gjendjes shëndetësore, në të drejtën për punësim, nga ana e Departamentit të Administratës Publike dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Gjendja shëndetësore)

(Fusha: Punësim)